


# MY TRING IPTV

MANUAL  
INSTALIMI  
DEKODER  
IPTV



## TELEVIZIONI YT

- VOD - Video me kërkesë
- Multiscreen
- DVR - Regjistrues i videove dixhitale
- EPG - Guida elektronike
- FAV - Lisa e të preferuarave
- Restart TV - Rifillimi i eventit




# Manual Instalimi

## DEKODER MY TRING IPTV



### Dekoderi My Tring IPTV në një vështrim të shpejtë



## Çfarë përfshihet



Dekoder My Tring IPTV



Manuali i Produktit (opsionale)

Manuali për Telekomandën (opsionale)

Manuali fillestar



Bateritë



Përshatësi i ushqyesit



Kabull Ethernet (opsionale)



Telekomanda



Kabull me dalje DIN dhe SCART

Telekomanda dhe Përshatësi i Ushqyesit mund të varen nga operatori i shërbimit.

**Artikuj shtesë që mund të kërkohen (jo të përfshira):**

- Kabull Ethernet
- Kabull HDMI
- Kabull RF Koaksial
- Kabull Audio Digjitale
- Ruter Rrjeti


## Funksionet kryesore të telekomandës

	Ndezur/fikur		Butonat me shigjeta për t'u zhvendosur brenda menysë dhe OK për të përzgjedhur
	Stop / Start / Pause playback		
GUIDE	Shfaq guidën e programit	INFO	Shfaq informacionet mbi programin
CH/PG	Lëviz kanalet poshtë e lart	MENU	Shfaq menyë apo faqen kryesore
VOL	Rrit apo ul volumnin	BACK	Kthehet mbrapsht një nivel brenda menyve
MUTE	Ul volumnin në maksimum	EXIT	Del nga artikulli aktual i menysë

## Hapi 1: Lidhja me TV

Përzgjidhni vetëm një opsion TV dhe më pas vazhdoni te Burimi i TV


Opsioni 1: Lidhje me HDMI (rekomandohet)



Kabulli nuk përfshihet



Opsioni 2: Lidhje me DIN-SCART




Kabulli përfshihet



## Hapi 2: Lidhja me Burimin e TV-së (Opsionale)

Lidhuni me Burim Kabllor TV-je të pakoduar apo Antenë (Antenë e jashtme apo e brendshme)



Kabulli nuk përfshihet



### Hapi 3: Lidhja me rrjetin

Përzgjidhni vetëm opsionin e Rrjetit dhe më pas vazhdoni me Ndezjen

**Opsioni 1:** Lidhuni me një Rrjet me Kabull nëpërmjet DSL-së, Modemit Kabllor apo Ruterit të Rrjetit



**Opsioni 2:** Lidhuni me Rrjetin Wireless me anë të një Ruteri Rrjeti Wireless

**Vini re:** Wi-Fi i brendshëm është një veçori opsionale e My Tring IPTV. Ju lutem kontaktoni me operatorin e shërbimit për disponueshmërinë dhe udhëzimet e detajuara në konfigurimin wireless të rrjetit.

### Hapi 4: Ndezja

**Përgatitja e Telekomandës**

1. Hapni kapakun e baterisë duke e shtypur atë dhe duke e rrëshqitur.
2. Futni bateritë, duke përkuar "+" dhe "-" në bateri me pjesën e brendshme të telekomandës.
3. Mbylleni kapakun.

**Vini re:** Ju lutem referojuni Manualit të Telekomandës për detaje

**Lidhja me Burimin e Energjisë**

1. Futni spinën te vendi i ENERGJISE në anën e pasme të aparatit.
2. Futni ushqyesin në prizë.
3. Ndiqni udhëzimet që dalin në ekran

**Vini re:** Sigurohuni që televizori të jetë i ndezur dhe inputi i saktë i videos të jetë përzgjedhur. Me Kabull nëpërmjet DSL-së, Modemit Kabllor apo Ruterit të Rrjetit



## Telekomanda dhe funksionet e saj



### STB

Dëshiron të kontrollosh My Tring Iptv me një buton? Mjafton të shtypësh butonin STB për të fikur ose ndezur pajisjen.

### MENU

Hap menyën e pajisjes

### INFO

Dëshironi të dini se kohëzgjatjen e programit të cilin po shikoni? Shtypni butonin Info dhe informohuni mbi gjithçka rreth programit që po shihni si: përmbajtja, aktorët, gjinia, orari dhe kohëzgjatja e programit. (EPG)

### OK

Nëse ju shtypni një herë këtë buton ai ju ndihmon për të realizuar një komandë të caktuar (zgjedh kanal nga guida etj) Nëse ju shtypni dy herë këtë buton do të lexoni përmbajtjen e programit (dmth luan rolin e INFO) 4 shqijetat për të lëvizuar majtas, djathtas, lart, poshtë

### BACK

Përzgjedhja e butoni Back shërben për tu rikthyer në veprimin e mëparshëm

### Exit

Përzgjedhja e butoni Exit shërben për tu rikthyer tek programi të cilin po shihnit.

### STOP

Ky buton shërben për të ndaluar një program në On Demand ose një program të regjistruar

### PLAY/PAUSE

Po ju telefon dikush në mes të një gare të rëndësishme? Shtypni butonin Pause edhe në një transmetim të drejtëpërdrejtë dhe rikthehuni për të parë gjithçka në momentin që e keni ndaluar duke shtypur butonin Play.

### REC

Shërben për të regjistruar një program nëpërmjet shërbimit DVR

### Butoni lejla

Ky buton ju çon direct në shërbimin e On Demand ( video me kërkesë)

### GUIDE

Ky buton ka një funksion të dyfishtë. Shtypja njëherë e tij ju nxjerr listen e kanaleve. Nëse e shtyp disa herë nxjerr edhe listen e kanaleve të preferuara.

### +/- VOL

Këto butona shërbejnë për të ngritur/ulur volumnin e televizorit.

### MUTE

E ul fare zërin e televizorit.

### +/- CHPG

Këto butona shërbejnë për ndryshimin e kanaleve,

### INPUT

Kombinimi i këtij butoni me atë të Menu (INPUT+MENU) ju dërgon tek opsioni I rregullimeve të hardëarit

### TXT

Buton me funksion të dyfishtë: nxjerr faqen e teletekstit ose aktivizon shfaqjen e titrave.

## Udhëzime të Rëndësishme Sigurie

- KUJDES: Për të ulur rrezikun e zjarrit apo shokut elektrik, mos e ekspozoni këtë aparat ndaj shiut dhe lagështirës.
- Aparati nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve apo spërkatjeve dhe asnjë send i mbushur me lëngje, siç janë vazot, nuk duhet të vendosen mbi aparat
- Lexoni këto udhëtime
- Ruajini këto udhëzime
- Mos i neglizhoni udhëzimet
- Ndiqini udhëzimet
- Mos e përdorni këtë aparat pranë ujit
- Pastrojeni vetëm me leckë të thatë
- Mos bllokoni hapësirat e ventilimit. Instaloni në bazë të udhëzimeve të prodhuesit.
- Mos e neglizhoni sigurinë që ofron spina e polarizuar dhe tokëzuar. Një spinë e polarizuar ka dy kunjë me njërin më të gjerë se tjetra. Spina e tokëzuar ka dy kunjë dhe një kunjë të tretë për tokëzimin. Kunja e tretë është vendosur për sigurinë tuaj. Nëse spina nuk i bën prizës suaj, konsultohuni me një elektriciist për të zëvendësuar prizën.
- Mbrojeni spinën duke mos shkelur mbi të apo duke mos lejuar që të dëmtohet te kunjat dhe te pika ku del nga aparati.
- Përdorni vetëm aksesore të specifikuar nga prodhuesi.
- Hiqeni aparatin nga prizat në rast rrefesh apo kur nuk përdoret për një kohë të gjatë.
- Për të gjitha shërbimet ndaj aparatit drejtoju personelit të shërbimit. Shërbimi kërkohet kur aparati është dëmtuar te kabulli i energjisë, nëse mbi aparat ka rënë ujë apo sende, nëse aparati është ekspozuar ndaj shiut apo lagështirës, nëse aparati nuk funksionon normalisht apo nëse ka rënë në tokë.
- Për të ulur rrezikun e shokut elektrik, MOS e zhvendosni kapakun apo panelin e pasmë. Brenda nuk ka pjesë që kërkojnë shërbim nga përdoruesi. Për shërbime, referoju personelit të kualifikuar.
- Për të mos lejuar shokun elektrik, futeni kabullin elektrik në brimet e duhura të tokëzuara. Përdorni vetëm kabuj shtesë dhe për-shtatës të tokëzuar, nëse nevojitet.
- Spina kryesore AC përdoret si pajisja për shkëputjen. Pajisja e shkëputjes do të qëndrojë e gatshme për punë.
- Mos lini asgjë mbi kabuj.
- Kabujt vendosini në atë mënyrë që ato të mos shkelen apo të pengojnë dikë.
- Mos derdhni ushqime apo lëngje në njësi.
- Mos futni asgjë në hapësirat e lira. Nëse e bëni këtë, mund të dëmtoni njësinë, mund të shkaktoni zjarr apo shok elektrik dhe mund të krijoni masë në përbërësit e brendshëm.
- Mos instaloni pranë aparatit asnjë radiator, ngrohës, soba apo aparate të tjera (duke përfshirë dhe amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi.
- Mos bllokoni ventilatorët e ftohjes.
- Mos i vendosni pajisjet në një njësi të mbyllur me mur.
- Kur shkëputni një kabull, tërhiqeni nga spina dhe jo vetë kabullin. Disa kabuj kanë një lidhës me kllapa mbyllëse; nëse shkëputni këtë lloj kabulli, shtypni kllapat para se të shkëputni kabujt.
- Kur të shkëputni kabullin, sigurohuni që spinat nga të dyja anët janë vendosur mirë, për të shmangur përthyerjen e kunjave.
- Për PAJISJE QE FUTEN NE PRIZE, kutia e prizës duhet të instalohet pranë pajisjes për akses të lehtë.
- Ndryshimet apo modifikimet që nuk aprovohen shprehimisht, mund të bëjnë që përdoruesi të mos e ketë të mundur që ta përdorë këtë pajisje.

## Deklaratë Konformiteti

Për të siguruar një përdorim të saktë të këtij produkti, ju lutem lexojeni me kujdes këtë manual dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Nëse njëjta kërkon mirëmbajtje, kontaktoni një shërbim të autorizuar.

KUJDES: Ky simbol tregon praninë e një voltazhi të rrezikshëm dhe të paizoluara brenda këtij produkti që rrezikun të shkaktojë shok elektrik. Mos e hapni kutinë e produktit.

MEMENDJE: Ky simbol tregon që duhet të bëni kujdes; ka një rrezik dëmtimi për pajisjen apo për veten tuaj.

Deklaratë Konformiteti (Vetëm Evropa)

Ky produkt është konform Direktivave të Këshillit:

- Direktiva EMC 2004/108/EC
- Direktiva e Voltazhit të Ulët 2006/95/EC

Deklarata e Industry Canada:

Kjo pajisje përputhet me RSS-210 të Rregullores së Industry Canada. Operacioni i nënshtrohet dy kushteve në vijim: 1) Kjo pajisje mund të shkaktojë ndërhyrje të dëmshme dhe 2) kjo pajisje duhet të pranojë çdo ndërhyrje të marrë, duke përfshirë ndërhyrjet që mund të shkaktojnë operacione të padëshiruara.

Deklaratë për Ekspozimin ndaj Rrezatimit:

Kjo pajisje është në përputhje me kufijtë e ekspozimit ndaj rrezatimit të IC-së për ambientet e pakontrolluara. Kjo pajisje duhet të instalohet dhe të punojë me një distancë minimale prej 20cm nga radiatori dhe trupi.

Për të parandaluar rrezikun e zjarrit apo shokut, mos e ekspozoni produktin ndaj shiut apo lagështirës. Për të ulur rrezikun e shokut elektrik, MOS e hiqni kapakun apo pjesën e pasme. Brenda nuk ka pjesë të cilave mund t'u bëhet shërbim nga përdoruesi. Për shërbime, referoju personelit të kualifikuar.

Deklaratë Konformiteti (Vetëm për SHBA-në)


Kjo pajisje përputhet me Pjesën 15 të Rregullores së FCC. Operacioni i nënshtrohet dy kushteve në vijim: 1) Kjo pajisje mund të shkaktojë ndërhyrje të dëmshme dhe 2) kjo pajisje duhet të pranojë çdo ndërhyrje të marrë, duke përfshirë ndërhyrjet që mund të shkaktojnë operacione të padëshiruara. Kjo pajisje është testuar dhe është në përputhje me kufijtë e pajisjes digjitale të Klasis B, në bazë të Pjesës 15 të Rregullores së Komunikimit Federal (FCC). Këta kufij kanë për qëllim që të ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme ndaj ndërhyrjeve të dëmshme në ambiente banimi. Kjo pajisje gjenon, përdor dhe mund të rrezatojë frekuenca, dhe nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret në përputhje me udhëzimet, mund të shkaktojë ndërhyrje të dëmshme në komunikimet me radio. Megjithatë, nuk ka garanci që nuk ka ndërhyrje në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton ndërhyrje të dëmshme te sinjali i radios apo televizionit, gjë që mund të përcaktohet duke fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi inkurajohet që të rregullojë ndërhyrjen me një nga masat e mëposhtme:

- Të riorientojë apo të zhvendosë antenën
- Të Rritë distancën mes pajisjes dhe marrësit
- Të lidhë pajisjen me një qark të ndryshëm nga ai me të cilin është lidhur rrjeti
- Të konsultohet me shitësin apo një teknik me përvojë radioje dhe televizioni për ndihmë.

Kujdes: Ndryshimet apo modifikimet që nuk aprovohen shprehimisht, mund të bëjnë që përdoruesi të mos e ketë të mundur që ta përdorë këtë pajisje

Ky transmetues mund të vendoset që të operojë në të njëjtën kohë me çdo antenë apo transmetuesi tjetër. Deklaratë për Ekspozimin ndaj Rrezatimit: Kjo pajisje është në përputhje me kufijtë e ekspozimit ndaj rrezatimit të FCC-së për ambientet e pakontrolluara. Kjo pajisje duhet të instalohet dhe të punojë me një distancë minimale prej 20cm nga radiatori dhe trupi.

# MY TRING IPTV



Kompleksi "Don Bosko",  
Kulla VII, Kati II,  
Tiranë, Albania  
**T:** +355 44 800 000  
**E:** info@tring.al

tring.al